Outlook

Re: Kerkese per informacion Nr 3-2025

From Info <info@bashkiasarande.gov.al>
Date Mon 12/29/2025 3:19 PM
To [redacted]

Përshëndetje,

Në lidhje me kërkesën bashkëlidhur e-mailit tuaj mund te sqarojme si me poshtë:
Për sa i përket pikës 1 dhe 2 bashkia Sarandë nuk disponon një regjistër të unifikuar të përmbledhur për lejet e zhvilimi dhe/ose ndërtimit të shqyrtuara dhe/ose të miratuara, pasi legjislacioni në fuqi VKM-së, nr. 430, datë 11.7.2018, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-leje)", nuk parashikon të detyrueshëm krijimin e një regjistri tjetër përvecse atij elektornik e-leje. Për më shumë mund të konfirmojmë informacionin e mëposhtëm se për periudhën prej korrik 2023 e deri në fund të nëntorit në sistemin elektronik e-leje janë kryer rreth 1190 aplikime, nga të cilat sëbashku me aplikime të mbartura janë shqyrtuar më shumë se 1250 aplikime. Gjatë kësaj periudhe titullari i institucionit ka dal me vendimmarrje pozitive për 70 leje zhvillimi, 156 leje ndërtimi (nga të cilat 20 për struktura akomoduese/turistike/hoteleri), 12 çertifikata përdorimi, dhe mbi 155 deklarata paraprake për kryerje punimesh. Në total, rreth 35% e vendimmarrjeve ka përfunduar me miratim të praktikave të shqyrtuara. Momentalisht janë duke u shqyrtuar më shumë se 150 aplikime nga specialistët e sekretariatit teknik pranë DPKZHT. Ndërkaq mbështetur në pikat në vijim të kërkesës tuaj, si dhe në mbështetje të ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ju bëjmë me dije se:

1. Nenit 9, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:
"Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre."
2. Nenit 45, pika 3, të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:
"Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përkasin këto të dhëna. Pëlqimi nuk kërkohet nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore."
3. Nenit 6, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:
"Të dhënat personale përpunohen: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin; b) nëse përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave; c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave; ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat; dh) nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private."

4. Nenit 17, pika 1, të ligjit 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:

"E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat.

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ."

Për sa më sipër cituar, Bashkia Sarandë nuk mund tju vë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Dhënia e dokumentacionit mund të kryhet vetëm me Kërkesë/Vendim të Gjykatës kompetente, ose me miratimin e shprehur të personit të cilit i përket ky dokumentacion.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.